



KOLEGJI
UNIVERSUM

**RREGULLORE PËR TRANSFERIMIN E STUDENTËVE NGA
BARTËSIT E TJERË TË ARSIMIT TË LARTË TË AKREDITUAR**

2013

Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-03, përkatësisht nenit 13 paragrafi 1 dhe paragrafi 2.2, Udhëzimin Administrativë Nr.11/2013 për verifikimin e diplomave dhe dokumentacionit tjetër si dhe Statutit neni 139, Këshilli Drejtues i Kolegjit “Universum”, nxjerrë dhe miraton:

Rregulloren për Transferimin e Studentëve nga Bartësit e tjerë të Arsimit të Lartë të Akredituar

Dispozita të përgjithshme:

Neni 1

Kjo rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat e transferimit të studentëve nga Universitetet dhe bartësit privat që kanë akreditimit dhe licencim. Po ashtu, kjo rregullore përcakton kushtet dhe procedurat për ndryshim të programit të studimeve dhe transferimit të studimeve brenda institucionit.

Neni 2

Kjo rregullore mbështete në parimet dhe rregullat e Sistemit Evropianë të Transferimit të Kredive, me të cilat proklamohet lëvizja e studentëve nga një institucion në institucionin tjetër.

Neni 2

Të gjithë studentë e regjistruar në Universitete dhe bartës të tjerë të arsimit të lartë sipas afateve kohore të përcaktuara për regjistrim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (**tash e tutje MASHT**), gëzojnë të drejtën për transferim të studimeve në Kolegjin “Universum”, në program të ngjashme të studimeve.

Neni 3

3.1 Ndërsa, vetëm studentët që kanë realizuar kredi-ects në institucionet e tjera, kanë të drejtën e transferimit në Kolegjin “Universum”;

3.2 Transferimi i studentëve në Kolegjin Universum, lejohet në fillim të semestrit dimëror dhe në fillim të semestrit veror, ky afat është i përcaktuar me Udhëzimit Administrativë Nr.11/2013, të MASHT.

Neni 4

Studentët që transferojnë studimet në Kolegjin Universum, duhet ti dorëzojnë këto dokumente:

- Kërkesën me shkrim për transferimin e studimeve;
- Certifikatën e lindjes;
- Dëftesat dhe diploma e shkollës së mesme;
- Dëshminë e institucionit nga i cili transferohet;
- Transkripten e notave me kredi-ects të fituar nga institucioni që vjen, e cila duhet të jetë e validuar nga institucioni që transferohet me një datë të fundit.

Neni 5

5.1 Pas plotësimit të dokumenteve për transferim, drejtori i administratës verifikon dokumentacion dhe përcjell lëndën te drejtori i programit, i cili formon komision prej tre (3) anëtarëve për ekuivalentimin e kredive-ects në programin të cilin transferohet studenti;

5.2 Të gjitha lëndët që janë në përputhje me programin e akredituar të Kolegjit “Universum” njihen në parim, ndërsa ato lëndë të cilat janë të përfunduara nga studenti nuk përputhen me programin e studimeve të Kolegjit “Universum”, mund të njihen si lëndë zgjedhore;

5.2 Në vendim e marr nga drejtori i programit, gjithashtu duhet të specifikohen lëndët të cila duhet ti nënshtrohet studenti sipas programit të studimeve, si dhe numrin e kredive të cilat nevojiten për përfundimin e programit të studimeve;

5.3 Vendimi nga drejtori i programit merret jo më larg se një (1) javë pas pranimit të lëndës nga administrata për transferim dhe njoftohet administrata;

5.4 Njësit administrative janë të obliguar ti paraqesin lëndët dhe listat e studentëve të transferuar në qendër respektivisht te drejtori i administratës, sipas afateve të përcaktuara dhe duhet të presin aprovimin dhe vendimin për transfer.

Neni 6

6.1 Pas nxjerrjes së vendimit nga drejtori i programit, studenti e fiton të drejtën e transferimit dhe vijimit të programit të studimeve në Kolegjin Universum;

6.2 Studentit i dorëzohet vendimi dhe i ofrohet kontrata e studimeve për nënshkrim;

6.2 Kredit e përfunduara në institucionin pasardhës llogaritën në pagesë të studimeve dhe atë sipas normës 18.78 € për një (1) Ects-Kredi.

6.3 Të gjitha provimet e pranuar në vendim, administrata e Kolegjit “Universum” i evidenton në sistemin elektronik të notave, respektivisht në ueb-student.

Neni 7

Kërkesat që pranohen nga studentët për transferim jashtë afateve ligjore të parapara me udhëzimin administrativë nuk trajtohen dhe si të tilla refuzohen.

Neni 8

8.1 Të gjitha njësit akademike duhet të mbajnë libra të veçantë të protokollit, ku evidentohen studentët e transferuar dhe të gjitha dokumentet që lëshohen për studentët e transferuar duhet të kenë referencë numrin e protokollit nga këto libra për studentët të transferuar.

8.2 Dosjet e studentëve të transferuar nuk përfshihen me dosjet e studentëve të rregullt, por ato sistemohen me një folder të studentëve të transferuar.

Neni 9

8.1 Të gjithë studentët e transferuar nga institucionet e tjera sipas procedurave të lartcekura, duhet të evidentohen në librin amëz, ku formulohet një listë me studentët e transferuar dhe e njëjta përcjellët në MASHT, jo më larg se 20 marsi për semestrin veror;

8.2 Ndërsa studentët që janë transferuar me rastin e fillimit të vitit akademik, ata duhet të përfshihen me të gjithë studentët e rinj të regjistruar për at vit akademik, por jo më larg se 15 tetor për studime themelore, dhe jo më vonë se 15 nëntor për nivelin master;

8.3 Libri amëz i institucionit duhet të trajtohet dhe të plotësohet konform Udhëzimit Administrativë 22/2012 dhe të gjitha të dhënat e studentëve duhet të jenë të sakta.

Neni 10

Ndryshimi i programeve të studimit brenda Kolegjit “Universum”

9.1 Të gjithë studentët e regjistruar në Kolegjin “Universum” në një program të caktuar akademik, mund ta ndryshojnë programin akademik para përfundimit të vitit akademik;

9.2 Kërkesa për ndryshim të programit akademik i drejtohet drejtorit të administratës e shoqëruar me arsyetim dhe e njëjta duhet të trajtohen brenda 48 orëve dhe të njoftohet studentit;

9.3 Kompetent për ndryshimin e programit të studimeve është drejtori i programit, i cili duhet të lëshoj një vendim në të cilin specifikohet ndryshimi i programit të studimeve;

9.4 Pagesa e studimeve mund të ndryshohet nëse programi tjetër i studimeve ka një koste më të lartë të studimeve përmes ndryshimit të kontratës të studimeve, ndërsa provimet të cilat janë të njëjta ato njihen edhe në programin e ndryshuar të studimeve;

9.5 Me rastin e aprovimit të kërkesës për ndryshim të programit, administrata paraqet ndryshimin e programit edhe në librin amëz të dorëzuar në MASHT, ndërsa njësit administrative janë të obliguar ti paraqesin këto ndryshime në qendër.

Neni 11

Transferimi i studimeve brenda Kolegjit “Universum”

10.1 Të gjithë studentët e Kolegjit “Universum” e gëzojnë mobilitetin për transferim të studimeve nga njëra qendër, në qendrën tjetër të Kolegjit “Universum”;

10.2 Ky transferim nënkupton vazhdimin e studimeve në qendrën tjetër të Kolegjit “Universum”, në programet e njëjtë të studimeve;

10.3 Kërkesa për transferim të studimeve brenda Kolegjit “Universum” parashtrohet në administratë dhe e njëjta duhet të trajtohet jo më larg se 48 orë dhe të njoftohet studenti;

10.4 Njësit administrative kanë për obligim bartjen e dokumenteve të studentit, si dhe regjistrimin në listat e vijueshmërisë si dhe në të gjitha grupet dhe aktivitetet në njësinë e transferuar.

Neni 12

Dispozitat përfundimtare

Kjo rregullore zbatohet në përputhje me statutin dhe përjashton çdo akt juridik të Kolegji “Universum” i cili është në kundërshtim me këtë.

Këshilli Drejtues mund të delegojë fuqinë e tij, në Këshilla të departamenteve ose ndonjë organi tjetër dhe të ndryshojë kërkesat e parapara në këtë Rregullore, por vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe çështje të veçanta.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi tetë ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Drejtues.

Nënshkruar me datë 02.02.2013

Kryetari i Këshillit Drejtues

Suat Berisha